



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Prill 2021

Nr. 248

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Kryeministrit z. Edi Rama dhe zj. Milva Ekonomi
- Kërkues:** Partia Demokratike
- Ndaj:** Kryeministrit z. Edi Rama dhe zj. Milva Ekonomi
- Baza Ligjore:** Nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së gjatë shqyrtimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi Paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve nga Partia Demokratike, është raportuar një denoncim me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2937, ndaj Kryeministrit z. Edi Rama dhe zj. Milva Ekonomimi, me pretendimin se, në një bidesë telefonike, gjatë rrugës Leskovik-Përmet me Milva Ekonomin, Kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar mësuesit dhe infermierët



që të mbrojnë pozicionin e tyre me votë, në kundërshtim me nenin 91 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 6, pika 1 e vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

II. Rrethanat e faktit

Përmes linkut të vënë në dispozicion në denoncimin me nr. ID 2937 të gjeneruar nga sistemi, kryer nga kallëzuesi Partia Demokratike, administrata e KQZ-së, zbardhi të plotë bisedën telefonike të z. Edi Rama me zj. Milva Ekonomi, në videon e publikuar në “Facebook”, provë e vetme kjo në të cilën pala kallëzuese bazon denoncimin e saj.

Biseda telefonike e kryer mes tyre, pasqyrohet nga Partia Demokratike në këtë kallëzim si më poshtë vijon:

Milva Ekonomi: “Isha në Krujë dhe situata duket shumë mirë, ka shumë entuziazëm, sidomos tek të rinjtë që kanë hyrë në punë përmes portaleve tona “Mësues për Shqipërinë” dhe “Infermierë për Shqipërinë”.

Edi Rama: “Duhet ta mbrojnë pozicionin e tyre me votën në drejtim të paditur, përfundon në drejtim të paditur çdo gjë, edhe puna e tyre se e fillojnë prapë ata se nuk dinë gjë tjetër.”

Biseda e zbardhur nga administrata e KQZ-së, në videon e linkut që vetë kallëzuesi ka vënë në dispozicion, në fakt rezulton të jetë si më poshtë vijon:



Milva Ekonomi: “...Unë jam aktualisht në Krujë, isha në Krujë sot edhe në Aramenas dhe dje isha në Durrës. Në fakt duket shumë mirë, ka shumë entuziazëm, sidomos te kjo pjesa e të rinjve që kanë hyrë nëpër punëra **nëpërmjet meritokracisë** në portalet tona me portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe “Infermierë për Shqipërinë”. Janë super entuzianstë, super entuziastë.”

Edi Rama: “Tani, mësuesit për Shqipërinë dhe Infermierët për Shqipërinë, kanë hyrë **me meritën e tyre**, po çështja është që, duhet ta mbrojnë pozicionin e tyre se, me votën në drejtim të paditur përfundon në drejtim të paditur çdo gjë, **këtu në këtë vend**, plus edhe puna e tyre, se fillojnë prapë nga e para *ata*, se nuk dinë *ata* gjë tjetër, e ke parasysh.”

Milva Ekonomi: “Edhe *ata* vetë e kishin parasysh shumë mirë këtë gjë, se kishin vuajtur gjatë për ta fituar këtë vendin, edhe pse kishin dalë mirë me rezultate...”

Këto deklaratatë kryera nga Kryeministri z. Rama dhe zj. Milva Ekonomi, sipas denoncuesit bien ndesh me parashikimet e nenit 91 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 6, pika 1 e vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator.

III. Analiza ligjore

Në vlerësim të provave dhe fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhor çmon se:

Referuar nenit 91 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar:

1. *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.*

2. *Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të*

marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.”

Për sa më sipër, në provën e paraqitur nga pala kallëzuese Partia Demokratike, që konsiston në një link i rrjetit social “Facebook”, i videos të postuar në faqen zyrtare të Kryeministrit z. Edi Rama, biseda telefonike e zhvilluar mes tij dhe kandidatës për deputete zj. Milva Ekonomi, nuk përbën indicie se mësuesit dhe infermierët e përmendur në bisedë, mund të jenë përdorur në mënyrë të detyruar në fushatën zgjedhore të subjektit politik përkatës, apo mund t’ju jenë premtuar ose ofruar përfitime për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe mund të jetë ushtruar presion ndaj tyre për këtë qëllim.

Referuar nenit 6, pika 1 të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, parashikohet se:
“Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës zgjedhore, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscenimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese për të ushtruar pa ndikim lirinë e shprehjes dhe/ose për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi dhe në këtë vendim”.

Gjatë bisedës së zbardhur mes z. Edi Rama dhe zj. Milva Ekonomi, nga administrata e KQZ-së, rezultojnë se fjalë të tilla si: **meritokracia** thënë nga zj. Milva Ekonomi dhe **këtu në këtë vend** thënë nga z. Edi Rama, janë hequr nga kallëzimi që Partia Demokratike ka paraqitur në denoncimin e saj, duke sugjestionuar kështu një tjetër kuptueshmëri të paragrafit, të ndryshëm nga ai i ndodhur realisht. Në tërësinë e saj, kjo bisedë telefonike rezultojnë të jetë një bisedë e kryer në kuadër të fushatës elektorale për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Gjuha e përdorur nga dy kandidatët pjesëmarrës në këtë fushatë, në këtë bisedë telefonike, në kuptim të nenit 6, pika 1 të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, nuk përbën indicie për cënim të të drejtave dhe lirive kushtetuese, të punonjësve të administratës shtetërore, për të ushtruar pa ndikim lirinë e shprehjes dhe/ose për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi dhe në këtë vendim.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përmbushje të përgjegjësisë së veta për të organizuar dhe administruar zgjedhjet e datës 25 Prill e në përputhje me standartet më të mira, u ka bërë apel të vazhdueshëm të gjithë aktorëve politikë për vetëpërmbytje dhe maturi, në sjelljen dhe gjuhën e tyre elektorale.



Mesazhet dhe apelet publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve do të vazhdojnë të kenë në fokus respektimin e standardeve për zgjedhje të qeta, të lira e të ndershme.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për kallëzimin e kryer nga Partia Demokratike çmon se, thëniet e z. Edi Rama dhe zj. Milva Ekonomi gjatë bisedës telefonike të tyre, nuk përbëjnë indicie të besueshme për të nisur hetimin administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Kryeministrit z. Edi Rama dhe zj. Milva Ekonomi pasi nuk konstatohen shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

